# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449904**

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Të dhënat e qindra klientëve të evropianë të një banke dixhitale bien në duart e hakerëve - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/te-dhenat-e-qindra-klienteve-te-evropiane-te-nje-banke-dixhitale-bien-ne-duart-e-hakereve/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 16:34:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 16:31:28 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8a255aebc9b10b3dedfcd4604e3f7be6bf62018a94054f8493cb27ffa632796c` |
| TEKSTI | `89fa6882396ad4170b7f9f0bfaf5418d1c3bc40206754964df2c4f176a423194` |
| PAMJA | `d855a8cb5331b7fe2291f8d45207558f1f7f7095d064246df7c21f6a40da8de1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `800631bf7363e21a4187e04a946cd9ed11c8a668af35d57aa5c61aceba9acc22` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/800631bf7363e21a4187e04a946cd9ed11c8a668af35d57aa5c61aceba9acc22`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

EVROPA

# Të dhënat e qindra klientëve të evropianë të një banke dixhitale bien në duart e hakerëve

16 Shtator 2026 | 18:31

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Të dhënat personale të qindra klientëve evropianë të bankës dixhitale Revolut janë marrë nga hakerë, të cilët u paraqitën në mënyrë të rreme si një agjenci qeveritare.

Revolut tha se kishte zbuluar një "mashtrim të sofistikuar të imitimit të jashtëm", ku një palë e paautorizuar përdori një adresë email-i nga një domen legjitim qeveritar për të bërë kërkesa mashtruese për informacionin e klientëve.

Sipas *Financial Times*, hakerët italianë përdorën një llogari email-i të komprometuar të qeverisë italiane për t'u paraqitur si zyrtarë. Rreth 680 klientë në disa vende evropiane dyshohet se janë prekur.

Mes të dhënave të marra raportohet se përfshihen adresa, fotografi verifikimi, dokumente identiteti dhe informacione mbi aktivitetin e bitcoin.

Revolut deklaroi se sistemet dhe fondet e klientëve nuk janë prekur nga incidenti. Kompania tha gjithashtu se ka kontaktuar klientët e prekur dhe u ka ofruar mbështetje.

Pas zbulimit të incidentit, Revolut tha se bllokoi menjëherë adresën e përdorur në mashtrim dhe njoftoi autoritetet përkatëse qeveritare, të zbatimit të ligjit, të mbrojtjes së të dhënave dhe rregullatorët financiarë.

Ndërkohë, Zyra britanike e Komisionerit të Informacionit konfirmoi se kishte marrë një raport për incidentin dhe po vlerësonte informacionin e paraqitur.

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

EVROPA

**Franca kërkon të bindë BE-në për heqjen e sanksioneve ndaj Alisher Usmanov**

## LAJMI I FUNDIT

18:31 **"Do t'i biem pishmanit, por do jetë vonë"/ Momenti kur Rexhep Selimi i lutej Jakup Krasniqit kundër Gjykatës Speciale**

18:15 **Zhduket 3-vjeçari nga këndi i lojërave në Angli, mbi 1 000 persona mobilizohen në kërkime për gjetjen e tij**

18:07 **Planeti nën sulm nga dy stuhi diellore: Cilat zona do të preken?**

18:01 **Shembet miniera e arit në Sudan, 82 të vdekur dhe 50 të plagosur**

18:00 **Plagosje me armë zjarri në Durrës**

17:53 **Sulmi me dron ukrainas vret gjeneral-majorin rus, u shpall "Hero i Rusisë" pak ditë më parë (VIDEO)**

TESTIM

Franca ka një javë kohë për të siguruar vendet e tjera të BE-së se përpjekjet e saj për të hequr një miliarder të diskutueshëm ruso-uzbek...

17:23 | 16/09/2026

BOTA | EVROPA

### Rezultatet e dobëta tronditin CDU-në, Merz ultimatum drejtuesve të partisë: Më mbështesni ose jap dorëheqjen

Nën presionin e rezultateve të njëpasnjëshme negative në zgjedhje dhe vlerësimeve të ulëta të Partisë Kristian Demokratike (CDU) dhe të vetë kancelarit në sondazhet e...

07:45 | 16/09/2026

EVROPA

### BE masa të reja për të lehtësuar lëvizshmërinë e punëtorëve

Komisioni Evropian miratoi sot një paketë të re masash për të lehtësuar lëvizshmërinë ndërkufitare të punëtorëve dhe për të forcuar të drejtat e tyre sociale , duke...

20:59 | 15/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.